



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	09.07.2026
REFERENC-Ë:	1867/26/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan për HC Lumbardhi II
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan për HC Lumbardhi II me Nr. Prot. 1867/26, të datës: 10.04.2026.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për Refuzimin e Lejes Mjedisore për operatorin "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan për HC Lumbardhi II.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 1867/26/MMPH
Datë: 09.07.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 12 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, i refuzohet kërkesa për pajisje me Leja Mjedisore për HC Lumbardhi II.

A r s y e t i m

Komisioni për shqyrtimin e Lejeve Mjedisore refuzon kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore për operatorin "Kelkos Energy" SH.P.K., Deçan, për HC Lumbardhi II, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore për arsyet e cekura më poshtë:

- Gjatë realizimit të vizitës në teren, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka konstatuar se ka ndryshim të projektit ideor për të cilin operatori është pajisur me Pëlqim Mjedisor, ku në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si pjesë përbërëse e funksionit të HC Lumbardhi II është planifikuar te Zalli i Rupës ndërtimi i një rezervuari me vëllim 3.5 mil. m³, një mesatare e nivelit të ujit prej 20 m dhe një pendë e lartë 40 m, ndërsa në teren është konstatuar se Zalli i Rupës nuk është pjesë përbërëse e HC Lumbardhi II. Sipas Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 29, paragrafi 1:



"1. Vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis bëhet për projekte të cilat planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar, duke përfshirë edhe ndryshimet e teknologjisë, rekonstruimin, zgjerimin e kapaciteteve ose ndërprerjen e punës, gjë që mund të sjell deri te ndotja e mjedisit ose mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut."

- Sipas Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 2- Projektet që ekzaminohen rast pas rasti, pika 12 (12.11):

"12.11. Çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të dhëna në Shtojcën 1 ose Shtojcën 2, të cilat janë të lejuara, të realizuara ose në proces të realizimit, të cilat mund të kenë ndikime të theksuara jo të favorshme në mjedis (ndryshimi ose zgjerimi që nuk është përfshirë në Shtojcën I)"

Andaj bazuar në atë që u theksua më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, meri Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore.

Ky vendim hyr në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D.i Sekretarit të Përgjithshëm i
MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Deçanit;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit;
- Arkivit të MPMH-së.